



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim paraprak përqendrimi

Rasti: Përfitim kontrolli JTI HBV / V.D.M Invest Comm. VA

Në datën 22 Qershor 2012, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të Marrëveshjes për Blerjen e Aksioneve ndërmjet shoqërive aksionere GT & Co dhe JT International Holding B.V, më datë 23 Maj 2012, me objekt përfitim e kontrollit të vetëm në shoqërinë V.D.M Invest Comm. VA nga shoqëria JT International Holding B.V, me anë të transferimit të 99.99% të aksioneve.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **JT International Holding B.V:** ushtron veprimtarinë e saj në prodhimin dhe shitjen e cigareve të prodhuara nëpërmjet makinerive (MMC) dhe produkteve të tjera të duhanit;
- **V.D.M Invest Comm. VA:** ushtron veprimtarinë e saj në fushën prodhimit dhe shpërndarjes së duhanit të dredhur si dhe në shpërndarjen e aksesorëve të pirjes së duhanit (pipa, letra duhani, filtra, etj).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b) dhe 12, pika 1 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al